



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.70/6 prot

Datë. 26.01.2024

V E N D I M
Nr. 98 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Mbyllet e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023, nga autoriteti kontraktor, “Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023, nga autoriteti kontraktor, “Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë”.

Ankimues:

Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK, me Nipt. K11507003S, Adresa: Rruga: “Bardhok Biba”, Pallati Trema, Hyrja C, Tiranë.

Operatori ekonomik "NELSA" SHPK, me Nipt. J71601012S.
Adresa: Rr: Tiranë - Dajt, Lagja "Qesarakë", Nr. Pasurie
199/32, Hyrja 1, Dajt, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.
Adresa: Rruga "Maliq Muco" nr.19 ,Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues, për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.12.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN*”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, “Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë”.

II.2. Në datë 29.12.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 05.01.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. NELSA ShPK	me ofertë	2,446,752	Lekë pa TVSh	skualifikuar
2. DAJTI PARK 2007 ShPK	“	2,505,008	“	skualifikuar
3. 4 S ShPK	“	2,529,440	“	skualifikuar

II.4. Në datën 09.01.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim - anulimi të procedurës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Në datën 11.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 70/2024 prot., e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN*”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, “Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112, “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 70/2 prot., datë 12.01.2024, lidhur me pretendimet e ankimuesit “DAJTI PARK 2007” SHPK, mbi arsyet e skualifikimin të ofertës së tij.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2/1 prot., datë 18.01.2024, protokolluar me tonën me nr.70/3, datë 19.01.2024, me objekt: “Njoftim - Vendimi”, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin Nr.2, datë 17.01.2024, të KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “DAJTI PARK 2007” SHPK.

II.8. Në datën 15.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 86/2024 prot., e operatorit ekonomik “NELSA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

II.9. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.86/2 prot., datë 16.01.2024, lidhur me pretendimet e ankimuesit “NELSA” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “NELSA” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 4 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën me nr.86/3, datë 24.01.2024, autoriteti kontraktor ka paraqitur “Informacion” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe vendimin me Nr.3. Prot., datë 23.01.2024, të KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur pranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “NELSA” SHPK.

II.11. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” nuk janë paraqitur argumente në formë shkresore apo online, nga operatorë të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “NELSA” SHPK,

“Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Nelsa ShPK, Rezulton se nuk është plotësuar pika 2.3 .5 Kapciteti Teknik sipas DST, 2.3.5-e DHE 2.3.5-f, Operatori ekonomik nuk ka provuar me deklaratë nga Administratori i Shoqërisë që Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

Operatori ekonomik ka në mungesë dokumentacionin Leje Higjieno-Sanitare për automjetin, lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik”, ankimesi kundërshton e skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit.

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin Nr.3. Prot., datë 23.01.2024, të KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ka vendosur pranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “NELSA” SHPK.

Në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar se:

[...] Referuar VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka parashikuar se AK pranon si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, AK i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese. [...]

Bazuar në nenin 114/3 Ligji 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i shqyrtimit të ankesave, pasi mori në shqyrtim ankesën,

Vendos

Pranimin e plotë të ankesës.

III.1.2. Referuar Nenit 30 i LPP-së parashikon se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *I. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës,*

Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.4. Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Komisioni do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen:

- *Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK, rezulton, se nuk është plotësuar pika 2.3.7 Kapaciteti Teknik sipas DST, 2.3.7-b DHE 2.3.7-c.*

Operatori ekonomik nuk ka provuar se disponon Lejen nga QKL për pelqim mjedisor për aktivitetin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, si dhe Lejen higjeno-sanitare për objektin në fjalë.

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.7 sipas DST, pikën b dhe c.

III.2.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcën 8, Kritere të Përzgjedhjes /Kualifikimit, pika 2.3.7 ku është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë të pakten 1 ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Për të plotësuar këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Dokumentacionin që verteton pronesinë ose marrjen me qira të këtij ambienti për aktivitetin prodhim dhe shpërndarje të ushqimit të gatuar .*

b. Lejen nga QKL per pelqim mjedisor per aktivitetin e gatimit dhe shperndarjes se ushqimit.

c. Leje higjeno - sanitare per objektin ne fjale.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.3. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.4. Në nenin 40, pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.2.5 Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon mbi dokumentacionin e procedurës së prokurimit e konkretisht autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriterin 2.3.7.

Operatori ekonomik duhet te disponoje te pakten 1 ambient ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit. Per te plotesuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese:

- a. Dokumentacionin qe verteton pronesine ose marrjen me qira te ketij ambienti per aktivitetin prodhim dhe shperndarje te ushqimit të gatuar .*
- b. Lejen nga QKL per pelqim mjedisor per aktivitetin e gatimit dhe shperndarjes se ushqimit.*
- c) Leje higjeno - sanitare per objektin ne fjale.*

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posacme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është gatimi dhe shpërndarja e ushqimit, pra operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menusë të ushqimit të miratuar, nga Autoriteti Kontraktor, konform normës bazë të ushqimit, sipas standardeve tekniko-teknologjike dhe për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.”*

Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me nr. 70/2024 datë 11.01.2024 ka lidhje me vendimin e autoritetit kontraktor të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Akoma më tej, referuar nenit 118, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të

refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji”.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorëve ekonomikë për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi objektit të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet dhe shërbimet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumente që garantojnë cilësinë e pretenduar.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti/shërbimi i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave/shërbimit të ofertuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet

ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues si edhe referuar kritereve për kualifikim, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar Ligji Nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” (I ndryshuar) konstaton, se përcaktimi *Leje për pëlqimin mjedisor*, sikurse autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriterin kualifikues 2.3.7. pika b), nuk ekziston në ligj.

Referuar Proces Verbalit Mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e kërkesave të kriterit 2.3.7/b) e konkretisht: Bazën ligjore “Për Lejet Mjedisore”, Emërtimin e saktë , Kategorinë, Fushën e veprimtarisë, të dhëna të cilat duhet të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave. Në këtë kontekst është e paqartë dhe konfuze mënyra e plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucione të autorizuara por edhe për autoritetin kontraktor është e vështirë mënyra e vlerësimit të ofertave të paraqitura.

Komisioni thekson se, një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit ndaj qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret kriteri i mësipërm ka vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik në lidhje paraqitjen e dokumenteve të kërkuara. Në këtë mënyrë Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter konfuz dhe diskriminues.

Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, *parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces*. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacion sektorial. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi si dhe t’i japin mundësi sa më shumë ofertuesve të marrin pjesë në garë për të fituar kontratën.

Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të*

veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...], në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret e kualifikimit në lidhje me kërkesat për disponimin:

Lejen nga QKL per pelqim mjedisor per aktivitetin e gatimit dhe shperndarjes se ushqimit.

është kriter evaziv, përjashtues vështirëson operatorët ekonomik, krijojnë konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Mospërcaktimi i saktë i kriterit, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kriteret jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi, duke hartuar një kriter të saktë dhe të qartë në përputhje me parashikimet ligjore.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, “Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë”.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023, nga autoriteti kontraktor, “Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë”.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor përpara publikimit të procedurës së prokurimit të sjellë pranë KPP-së kopje të DST.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

